



V E N D I M

Nr. 35 Datë 21.03. 2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PER MIRATIMIN E METODOLOGJISE SE LLOGARITJES TE TARIFAVE PER KOMPANINE PUBLIKE TE GJENERIMIT, METODOLOGJISE SE LLOGARITJES TE TARIFAVE PER FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICE TE ENERGJISE ELEKTRIKE, METODOLOGJISE SE LLOGARITJES TE TARIFAVE TE SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE DHE METODOLOGJISE SE LLOGARITJES TE TARIFAVE PER FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICE TE ENERGJISE ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 44, datë 24.07.2004, "Për Miratimin e Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s", nenit 18, pika 1, germa g, dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 21.03.2008, pasi u njoh me draftet e Metodologjive te paraqitura,

VENDOSI :

1. Fillimin e Procedurave të Miratimit te Metodologjise te Llogaritjes se Tarifave per Kompanine Publike te Gjenerimit, Metodologjise te Llogaritjes se Tarifave per Furnizuesin Publik me Shumice te Energjise Elektrike, Metodologjise te Llogaritjes se Tarifave te Shperndarjes te Energjise Elektrike dhe Metodologjise te Llogaritjes se Tarifave per Furnizuesin Publik me Pakice te Energjise Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Cmimeve dhe Tarifave si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, për ndjekjen e procedurave ligjore per miratimin e ketyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta